

05 05-8056
-60- 18 10 24



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës
National Association of Pharmacists
Chemists of the Republic of Kosovo

No. Bt. No. 217 dt 18/10/2024



PËR: z. Arsim Qavdërbasha - Zyrtar përgjegjës për hartimin dhe finalizimin e Projektligjit për Shëndetësi

CC: z. Arben Vitia – Ministër i Ministrisë së Shëndetësisë
z. Naim Bardiqi – Sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë

NGA: Dr. Pleurat Sejdiu, Mr. Sci., Kryetar, Oda e Mjekëve të Kosovës (OMK);
Prof. Dr. Blerim Kamberi, Kryetar i Odës së Stomatologëve të Kosovës (OSK);
Mr. Ph. Kadri Bytyqi, Kryetar i Odës së Farmacistëve të Kosovës (OFK);
Ma. Bsc. Nexhmije Gori, Kryetare e Odës së Infermierëve të Kosovës (OIK);
Ass. Msci. Feim Gashi PT, Kryetar i Odës së Fizioterapeutëve të Kosovës (OFTK);

LËNDA: Komentet në Projektligjin për Shëndetësi

Datë: 18/10/2024

I nderuari z. Qavdërbasha,

Në mbështetje të nenit Neni 10, paragrafi 1 me nënparagrafin 1.5 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr. 04/L-150, si palë me interes në këtë proces, Odat e Profesionistëve Shëndetësor me vëmendje të veçantë kanë analizuar dhe shqyrtuar përmbajtjen e Draft Ligjit për Shëndetësi, me ç'rast kanë paraqitur komentet e tyre për përmbajtjen e këtij drafti.

Para se të paraqesim komentet tona për këtë përmbajtje, dëshirojmë të theksojmë indignatën dhe revoltën tonë për mënyrën e punës së grupit punues, transparencën e punës ku nga fillimi i procesit të draftimit të këtij ligji, Odat e Profesionistëve Shëndetësorë si përfaqësues të rreth 45 mijë profesionistëve shëndetësorë janë përjashtuar tërësisht nga ky proces, duke u punuar ky draft pa pjesëmarrjen e përfaqësuesve të OPSH dhe nga persona me inkompetencë të plotë për disa profile shëndetësorë si stomatolog, farmacist, fizioterapist.

Përmbajtja e këtij draft ligji, është rrënuese për autonominë e Odave të Profesionistëve Shëndetësorë e cila paraqet ndër reformat më të mëdha në sektorin shëndetësorë që nga paslufta duke mundësuar vetëorganizimin dhe administrimin e profesionistëve shëndetësorë, duke vepruar në kundërshtim të plotë me standardet evropiane të shteteve demokratike.

Duke qenë pjesë e sistemit shëndetësorë ne Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, kemi analizuar jo vetëm sferën e autonomisë së OPSH-ve por tërë përmbajtjen e ligjit.

Në mënyrë unike nga të gjitha Odat, kemi ardhur në përfundim se drafti i propozuar është në kundërshtim me aktet e mëposhtme :

1. Drafti i ligjit është në kundërshtim me vlerat demokratike të proklamuar me Kushtetuten e Republikës së Kosovës, me vlerat, legjislacionin me interes vital, ekonominë e lirë të tregut
2. Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr. 04/L-150
3. Ligjin për Zyrarët Publik nr. 08/L-197
4. Ligjin për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-40
5. Ligjin për Arsimin e Lartë nr. 04/L-037
6. Ligjin e Punës nr. 03/L-212
7. Marrëveshjen e Berlinit
8. Ligji për Profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës nr. 05/L-066
9. Ligjin për prokurimin publik në Republikën e Kosovës nr. 04/L-042

Për të gjitha këto shkelje të dispozitave, kemi hartuar propozimet tona për secilin nen të Draft Ligjit, të cilat janë të domosdoshme të përfshihen në mënyrë që i njëjti të jetë konform standardeve dhe praktikave më të mira evropiane për rregullimin e sektorit shëndetësorë dhe përputhshmërinë e draftit me legjislacionin aktual, të cilat i kemi bashkangjitur si shtojcë në këtë shkresë.

Odat e Profesionistëve Shëndetësor mbeten të përkushtuar për realizimin e misionit ligjor të tyre, duke shfrytëzuar të gjitha mekanizmat ligjor deri në realizimin e plotë të interesave të anëtarëve të tyre.

Me respekt,

Prishtinë, 18 Tetor 2024

Kryetari i OMK

Dr. Pleurat
Sejdiu, Mr. sci

Kryetarja e OIK

Ma. Bsc.. Nexhmije
Gori

Kryetari i OSK

Prof. Dr. Blerim
Kamberi

Kryetari i OFK

Mr. Ph. Kadri
Bytyqi

Kryetarja e OFTK

Ass.Msci. Feim
Gashi-PT